

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E SHOQERIVE PUBLIKE

URDHER

AKSIONISTIT TE VETEM TE SHOQERISE ANONIME
KANTINA E PIJEVE "GJERGJ KASTRIOTI SHENDERBEU"

DURRES

Nr.22/1 date 21.03.1996

Me cilesine e aksionerit te vetem te shoqerise anonime Kantina e Pijeve "Gjergj Kastrioti Skenderbeu" Durres, cilesi kete qe e kam ne baze te paragrafit te dyte te nenit 3 te Ligjit Nr.7926, date 20.4.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare" dhe ne baze te nenit 128 te Ligjit 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare";

Urdheroj:

1. Ne aktet e themelimit te shoqerise anonime Kantina e Pijeve "Gjergj Kastrioti Skenderbeu" Durres te behen ndryshimet e meposhtme:

Ne kapitalin themeltar te shoqerise te shtohet vlere e truallit prej 32,489,600 leke dhe numri i aksioneve 32,490 si dhe me nje siperfaqe prej 47,780 m². Keto ndryshime te behen ne piken 4 te Aktit te Themelimit dhe ne nenin 3 te Statutit te Shoqerise.

2. Vleresimi i truallit, qe do te behet shtese ne kapital sipas pikes se mesiperme, te behet sipas dispozitave ne fuqi.

3. Ngarkohet Drejtoria e Shoqerive Publike te beje veprimet perkatese per shtimin e kapitalit ne perputhje me parashikimet e nenit 33 te Ligjit Nr.7667 "Per rregjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen kryer ne te".

MINISTRI

DYLBER VRIONI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISE PUBLIKE DHE PRIVATIZIMIT
Drejtoria e Privatizimit te Sektoreve te S.M.E

URDHER
Nr 22/2 Date 15.06.1999

PER
ZMADHIMIN E KAPITALIT THEMELTAR TE SH.A "KANTINA E
PIJEVE GJ.K.SKENDERBEU " SH.A DURRES

Me cilesine e aksionerit te vetem, bazuar ne paragrafin e pare te nenit 2 te Ligjit Nr.8237, date 1.09.1997 "Per disa ndryshime ne Ligjin Nr.7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare", ndryshuar me Dekretin Nr.1195, date 14.08.1995, Ligjin Nr.8099, date 28.03.1996, Dekretin Nr.1631, date 1.11.1996 dhe Ligjin Nr.8158, date 7.11.1996", ne baze te nenit 152 te Ligjit Nr 7638 date 19.11.1992 " Per shoqerite tregtare".

Urdheroj:

1. Ne aktet e themelimit te "Kantina e Pijeve Gj.K.Skenderbeu " Sh.A Durres te behen ndryshimet e meposhtme :


Ne kapitalin themeltar te shoqerise " Kantina e Pijeve Gj.K.Skenderbeu " Sh.A Durres. te shtohet vlere 51.053.400.leke si rezultat

- a) perfshirjes ne kapital te rezervave
- b) fitimeve qe ka krijuar shoqeria gjate aktivitetit te saj

Numri I aksioneve shtohet 51.053. Kapitali themeltar gjithsej behet 339.543.000 leke.dhe numri I aksioneve 339.543.

Te behen keto ndryshime ne piken 4 te aktit te themelimit dhe ne nenin 3 te statutit.

2-. Ngarkohet Drejtoria e Privatizimit te S.M.E. -ve te beje veprimet perkatese perzmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise anonime "Kantina e Pijeve Gj.K.Skenderbeu " Sh.a Durres ne perputhje me parashikimet e nenit 33 te Ligjit Nr.7667 "Per rregjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen kryer ne te".





Nr. Prot. 132

R A P O R T

M B I

NDRYSHIMIN E KAPITALIT TE SH.A "GJ.K.SKENDERBEU" Durrës

Shoqeria eshte krijuar ne 16 Gusht 1995, dhe gjate ketyre viteve ka patur rezultate pozitive ne aktivitetin e saj.

Gjate kater viteve te fundit kjo Shoqeri ka shperndare Fitimin ne rezervat perkatese, keto te miratuara nga Keshilli Mbikqyres dhe nga Ministria e Ekonomise Publike dhe Privatizimit;

Gjithesej rezervat e akumuluar per kete periudhe jane:

1. Rezerva e Rivleresimit	26.976.144	leke
2. Rezerva Idgjore	1.458.046	leke
3. Rezerva e Zhvillimit	21.040.258	leke
4. Fitimi i vitit 1999- Dividentin	1.578672	leke

Meqenese SH.A Kantina e pijeve "GJ.K.SKENDERBEU" Durrës kalon ne privatizim, te gjitha rezervat e krijuara te kalojne ne kapital, duke krijuar nje kapital te ri prej 339.543.000 leke.

D R E J T O R I A

KRYETARI I DEGES EKONOMIKE

(LINDITA MUHEDINI)

KRYETARI I DEGES TEKNOLOGJIKE

(BASHKIM LAKNORI)



D R E J T O R I

(Astrit Hysi)